

Departamenti Amerikan i Punës

Konkluzione mbi Format më të Rënda të Punësimit të Fëmijëve gjatë vitit 2018

Shqipëria

Gjatë vitit 2018, Shqipëria ka bërë një përparim të moderuar në përpjekjet për të eliminuar format më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria ka vënë në zbatim Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.91 që përcakton rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen kur janë shkelur të drejtat e fëmijëve dhe që forcon rolin e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu qeveria ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 353 për të rregulluar funksionimin e grupit teknik ndër sektorial për të adresuar si duhet nevojat për mbrojtjen e fëmijëve. Qeveria ka rritur numrin e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës, ka trajnuar oficerët e policisë për të luftuar trafikimin e fëmijëve dhe ka shprehur gatishmërinë për të qenë një Vend Udhërrëfyes (Pathfinder Country) për Aleancën 8.7 për të shpejtuar zbatimin e Objektivave të Qëndrueshme të Zhvillimit lidhur me eliminimin e punës së fëmijëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore deri në vitin 2025.

Por pavarësisht këtyre masave, fëmijët në Shqipëri vazhdojnë të jenë të përfshirë në format më të rënda të punës, lypjen e detyruar dhe punën në minierat e kromit. Fëmijët gjithashtu kryejnë punë të rrezikshme në bujqësi. Edhe pse qeveria ka bërë përpjekje domethënëse në të gjitha fushat përkatëse gjatë kësaj periudhe raportuese, ligji nuk e ndalon në mënyrë eksplicite përdorimin, mashtrimin ose ofrimin e fëmijëve për aktivitete të paligjshme. Krahës kësaj, Inspektorati i Punës duhet të forcohet për të kryer inspektimet e nevojshme në të gjithë sektorët e njohur ku shfrytëzohet puna e fëmijëve.

Bazuar në raportime e bëra janë identifikuar e sugjeruar veprime që do të avancojnë më tej eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri.

Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
Kudri ligjor	Të garantohet që shfrytëzimi, mashtrimi dhe ofrimi i fëmijëve nën 18 vjeç për aktivitete të paligjshme, përfshi edhe në prodhimin dhe trafikimin e drogës, të ndalohet si vepër penale.	2015 – 2018
	Të garantohet që dispozitat e ligjit për punë të lehtë të kufizojnë numrin e orëve të punës së lehtë.	2018.
Zbatimi	Të rrisë koordinimin dhe komunikimin midis Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale dhe ti trajnojë mjaftueshëm njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve për të kryer punën e tyre.	2018.

Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
	Të sigurohet që Ministria e Brendshme të përqendrohet tek trafikimi i fëmijëve dhe të mos i përkushtojë të gjitha burimet ristrukturimit të aparatit gjyqësor dhe policisë.	2018.
	Të sigurohet që inspektorët e punës të inspektojnë sektorin informal, ku dihet që punësohen fëmijët, dhe që plani i Inspektoratit të Punës të jetë i plotë, dhe të këtë në objektivat sektorë ku dihet që punësohen fëmijë.	2010 – 2018
	Të forcohet dhe promovohet mekanizmi i referencës së ankesave të punës në mënyrë që publiku i gjerë të raportojë rastet e punës së fëmijëve.	2017 – 2018
	Inspektorati i Punës të pajiset me mjetet e nevojshme dhe të trajnohet në mënyrë që të mund të kryejë inspektime dhe të shtohet numri i inspektorëve të punës.	2017 – 2018
	Në juridiksionin e Inspektoratit të Punës të përfshihet edhe zbatimi i ndalimeve të trafikimit të qenieve njerëzore.	2018.
	Të sigurohet që si inspektorët e punës dhe hetuesit e policisë të marrin trajnim të shpeshtë rreth fëmijëve të angazhuar në format më të rënda të punës së fëmijëve.	2013 – 2018
	Të sigurohet që punonjësit e policisë kufitare të kontrollojnë siç duhet fëmijët e mitur, përfshi edhe fëmijët nga Kosova dhe emigrantët, dhe të zbatojnë siç duhet procedurat standarde të veprimit për të identifikuar viktimat e trafikimit të fëmijëve.	2016 – 2018
Koordinimi	Të forcohet koordinimi midis SLISS dhe Policisë së Shtetit të Shqipërisë.	2016 – 2018
Politikat e qeverisë	Të sigurohet që qeveria të zbatojë Planin e Veprimit Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga shfrytëzimi për përfitim ekonomik.	2018.
Programet Sociale	Të zhvillohen studime për të identifikuar më tej veprimtaritë e fëmijëve në bujqësi dhe ndërtim për t'i informuar për politikën dhe programet.	2013 – 2018
	Të caktohen masa për të ndihmuar fëmijët, familjet e të cilëve janë përfshirë në gjakmarrje, që të ndjekin shkollën.	2018.
	Të shtohen burimet, qasja në regjistrin civil, dhe shërbimet sociale të disponueshme për të miturit, përfshi fëmijët nga komunitetet Roma dhe Egjiptian, të përfshirë në ose të rrezikuar të përfshihen në punën e fëmijëve.	2011 – 2018

Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
	Të garantohet eliminimi i barrierave në arsim, si kostot penguese për pajisje shkollore dhe diskriminimi kundër fëmijëve Roma dhe Egjiptian dhe fëmijëve me paaftësi.	2013 – 2018
	Të ofrohen mësues të gjuhës përkatëse për fëmijët refugjatë dhe emigrantë dhe arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me paaftësi.	2018.
	Të shtohet numri i strehimoreve për fëmijët që referohen nga oficerët e policisë.	2017 – 2018
	Të futen programe që ndihmojnë fëmijët që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të atyre që shfrytëzohen në industrinë e nxjerrjes së kromit.	2014 – 2018
	Të sigurohet që të shtohen burimet financiare dhe njerëzore për programet sociale për punën e fëmijëve dhe që fondet sociale të decentralizuar për bashkitë të shpërndahen drejt dhe të jenë të mjaftueshme për të zbatuar programet.	2018.